



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt. 30.06.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi, (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar Komunës, drejtoret komunal, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloimbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga zyra për barazi gjinore
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Kryesuesi** - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 20 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 20 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për planifikimin e buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

**Enver Gashi** – Është një prej dokumenteve kryesore buxheti për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028. Ne si grup parlamentar jemi për që ky buxhet të kaloj sot pasi që i ka kalue të gjitha procedurat

e duhura, ka qenë edhe në debat publik. Ne e kemi shqyrtue edhe në udhëtimin zyrtar dhe jemi dakordue që të kaloj si i tillë prandaj, jemi për.

**Albana Shillova Shalaku** – Lëvizja Vetëvendosje parimisht është kundër këtoj dokumenti sepse kemi parë se mungojnë disa sqarime si për shembull te projektet me donatorë janë të paqarta, vetëm i keni paraqitë në tabelë. Pandaj kërkojmë nga ju më shumë sqarime sepse as nuk është sqaruar se a ka ndonjë kërkese që e keni sjellë në Kuvend për projektet me donatorë. Pastaj, te ndarja e buxhetit për paga nuk ka ndonjë specifikim të kategorive të zyrtarëve komunal. Te mallrat dhe shërbimet gjithashtu, te kontratat mbi veprën thuhet se janë ndarë 80,000 €, për ekspertët mbi çfarë baze është bërë kjo. Pastaj, te shërbimet e byfesë një shumë mbi 15,000 €, domethënë kogja shumë kështu që ne jemi kundër dhe kërkojmë disa sqarime.

**Ajet Berisha** – Sado që buxheti për çdo vit ka një rritje të konsiderueshme 16 milionë e 200 mijë, 16 milionë e 900 mijë, 17 milionë e gjysmë, nuk janë pak mjete për kokë banori që ka Obiliqi, mendoj se kjo rritje nuk po reflekton në investime kapitale, por po shkon shumica në mallra dhe shërbime dhe paga e meditje. Do të thotë këto 2 kategori janë jashtëzakonisht shumë duke u rritë që për mua është një vërejtje, a është e domosdoshme kjo apo ka nevoja tjera sepse po e shohë qe sa vite rend investimet kapitale janë 5 milionë e gjysmë, 6 milionë, 4 milionë e gjysmë. Sado që buxheti po rritet investimet kapitale dhe nevojat e mëdha që i ka Komuna e Obiliqit, nuk është që po përparojnë shumë sidomos kur kemi për bazë qe sa vite me rend 90 % të buxhetit e ndoshta, edhe më shumë po e merrë koggenericimi. Sado që ai projekt është shumë i nevojshëm për qytetarë, por hiç më pak të nevojshme nuk janë investimet tjera që kanë çalue jashtëzakonisht shumë. Është një dobësi e jashtëzakonshme e kësaj qeverisje për këto vite, sidomos përkëtë 4 vjeçar që nuk ka mund me sigurue asnjë centë shtesë për me mbulue koggenericimin si projekt i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme mjedisore, që unë mendoj me aplikime dhe me kërkesa të duhura. Mendoj se kjo qeverisje kishte mund me sigurue mjete, e jo gjithë buxheti për investime kapitale, apo me thënë më saktë dikund 90 % me shkue për koggenericim. Qytetarët janë duke e vërejtë mungesën e investimeve tjera, të domosdoshme për ata dhe janë duke i vuajtë këto pasoja për shkak të këtij projekti. Po ashtu, ka edhe paqartësi qe sa vite ka fillue edhe sa vite planifikoni më tepër mjete, edhe nuk i dihet fundi këtij projekti dhe nuk dihet sa ka me kushtue. Nuk ka njëfarë llogarie që kishim me pasë ne një siguri që koggenericimi kushton 50 milionë dhe këtu ka me përfundue. Unë mundem me kuptue se është dashtë ekspertët me planifikue edhe rritjen e çmimeve dhe me ardhë te ky çmim, por në bazë të këtyre planifikimeve dhe në bazë të kërkeseve për donatorë unë shohë që këtij projekti jo që nuk po i shihet fundi, por edhe do ta dëmtoj Komunën tonë në kuptimin e investimeve tjera, që janë shumë të nevojshme dhe nuk po ka mundësi me u realizue. Duke i pasë për bazë këto, unë do të votoj kundër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 8 vota kundër morën Vendim për aprovimin e planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shyrtimin dhe aprovimin e kërkësës nga zyra për barazi gjinore dhe për një shpjegim më të gjërë fjalën ia dha zyrtares të kësaj zyreje.

**Ganimete Aliu** – Ne e kemi bërë një kërkësë ku ministrja e drejtësisë në detyrë ka kërkuar prej Kryetarëve të Komunave të zyrtarizojnë këtë mekanizëm aty, ku nuk janë të themeluar të themelohen përmes Kuvendit. Ndërsa, aty ku janë të themeluar të rithemelohen ose të zyrtarizohen përmes Kuvendeve Komunale. Kjo kërkësë nuk ka asnjë implikim buxhetor, thjeshtë e rritë një përgjegjësi më të madhe ndaj institucioneve. Sa i përket rasteve të dhunës në familje për periudhën janar-qershori deri më tanë janë 28 raste.

**Kryesuesja** – Paraqiti emrat ose përbërjen e mekanizmit lokal koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje.

**Enver Gashi** – Ne nuk kemi çka debatojmë sepse kjo qenka kërkësë vetëm të kaloj përmes Kuvendit dhe implikime buxhetore nuk ka, kështu që ne jemi për aprovimin e kësaj kërkese.

**Sami Ahmeti** – Kërkesa si e tillë mua më duket pak kontradiktore. Në fillim thotë se ky Këshill është themelue në vitin 2018 pastaj, thotë se po kërkojmë me themelue tash. Kërkuesi thotë se nuk ka implikime

financiare, ndërsa në kërkesë thotë ju lutem të siguroni mjetet financiare për funksionimin e këtij Komisioni, që diçka më duket se nuk po shkon. Përndryshe, ne në parim sikur mos të ishin disa emra jemi për por për këtë do të abstenojmë.

**Ganimete Aliu** – Në kërkesë është qartësue mekanizmat kordinues kundër dhunës në familje janë të themeluar që nga viti 2018 në shumicën e Komunave, ku pjesë e këtij themelimi është edhe Komuna jonë. Në Komunën tonë është themeluar dhe mbështetë nga misioni i OSBE-së në Kosovë. Ky mekanizëm është themelue me një marrëveshje mirëkuptimi të gjithë akterët të cilët i ceku kryesuesja. Unë nuk kam çka të shtoj tjetër sepse nuk ka asnjë implikim buxhetor dhe planin e ka të aprovuar qysh në vitin e kaluar.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për dhe 3 vota abstenim morën Vendim për Themelin e mekanizmit lokal koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore me këtë përbërje: 1. Xhafer Gashi, Kryetar, 2. Brikena Pllana Mehami. DSHMS, 3. Edita Çanta, Gjykata Themelore Prishtinë, 4. Arlind Popaj, Prokuroria, 5. Mema Mjeku, ZMNY-Prokuroria, 6. Rejan Ibrahim, BIK-Obiliq, 7. Mexhid Krasniqi QPS, 8. Adlige Seta, Policia e Kosovës, 9. Zana Asllani, Strehimorja-QMGF, 10. Fatime Pllana, DKA, 11. Vjollca Hoti, QKMF, 12. Slavisa Adjancic, ZLK, 13. Faton Jashari, Ndihma Juridike Falas A.N.J.F. 14. Emine Berisha, Zyra e punësimit, 15. Ganimete Aliu, Njësia antidiskriminim dhe barazi gjinore, 16. Zelushe Kelmendi, Qendra Rinore.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se pasi nuk kemi asnjë kërkesë për shqyrtim kalojmë në pikën e radhës.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju keni pranuar një njoftim sa i përket kërkesës nga muaji i kaluar nga z.Berat Mehmeti, është një njoftim si procesverbal me disa fotografi.

**Enver Gashi** – Ne si Kuvend kemi kërkuar njoftime shtesë lidhur me mbledhjen e mbajtur dhe ato janë dërguar. Ne jemi në parim për këtë kërkesë që të aprovohet.

**Sami Ahmeti** – Tash, si pikë e rendit të ditës, apo nuk ka lidhje që është në pikën të ndryshme vetëm ta sqarojmë a është vazhdimi i pikës tjetër, a po doni prapë me dhënë në miratim peticionin që ka njerëz të vdekur brenda dhe që është hapë raport në polici, a po doni veç me na shpjegue për me u pastrue pakëz. Më fal kryesuese, që po të drejtohem ty, por e din ku e kam qëllimin sepse këtu është një shkresë mirrore e them, kjo nuk është dokument zyrtar, është një dokument që e ka shkrue tash vonë krejtë Edini dhe ky djali tjetër që është obligue e thotë me kërkesën e drejtorit të urbanizmit. Këtë çështje dua ta di se a po doni me shtye përpara kërkesën pa u bë modifikimet, pa u heqë peticioni, apo doni me vazhdue tjetër. Për informacionin e juaj për mos me lëndue familjen personi R.F. ka vdekë në janar të vitit 2024 ndërsa ju në peticion na e keni sjellë se ai po kërkon me bë një park dhe një odë për komunitetin. Ta keni parasysh se këtu është hapë një raport në polici sepse siç kam thënë në javën e kaluar mua më është dashtë me lajmëruet këtë rast. Në ndërkohë, që ju e sjellni edhe një dokument tjetër prapë të falsifikuar sepse nuk koïcidon as me datën, nuk koïcidon as me realitetin sepse në asnjë platformë elektronike nuk është kërkue dhe nuk është shpallë që do të ketë debat publik, e as nuk është shpallë në ditën e njejtë sikurse që bëhet në shumë raste tjera. Ta keni parasysh se ky rast tashmë iu ka dërgue drejtësisë.

**Kryesuesja** – Sa për sqarim z.Sami, në mbledhjen e kaluar ju kërkuat dokumente dhe thamë se në mbledhjen e radhës do të sjellen ato, për këtë unë jam e obliguar ato që më vijnë me i paraqitë para juve, por i keni edhe në email.

**Arben Berisha** – Unë kam kërkuar nga zyrtarët që kanë qenë në debat me bë raportin me dërgue me dëshmi me foto, që kanë qenë aty sepse ju kam premtue në seancën e kaluar se do të ua sjellë. Ne jemi plotësisht në rregullë me dokumentet që kërkohen për shpalljen e zonës me interes. Sa i përket çështjes së falsifikimit unë nuk e di, nuk e kam asnjë informatë, as unë nuk jam organ që e hetoj çështjen e falsifikimit z.Sami e këta ia kanë dorën kogja mirë se edhe disa diploma ia kanë nisë me i bë fals, por ajo është çështje e tij, nuk është e jona. Unë e kam dërguar lëndën, e juaja është ta hudhni në votim dhe unë ju kisha lutë për shkak të komunitetit atje, me i nisë procedurat e shpronësimit. Fati është se organi më i lartë Ministria, e bën vlerësimin dhe nuk është që e bëjmë ne sepse është çështje profesionale e Departamentit të veçantë.

Çështje e jona është me shpallë zonë me interes të përgjithshëm, me i nisë procedurat pastaj me ardhë deri te përfundimi i saj dhe ndërtimi i objekteve atje, ku i kërkon komuniteti.

**Ajet Berisha** – Përkundër sqarimeve, unë mendoj se z.Sami e dha një argument i cili është dashtë me stopue këtë procedurë ose edhe me inicue procedurë të re për veprimet tjera. Në rast se dokumenti i cili na është servue neve dhe njeriu në Kuvend e dëshmon se ka falsitet, tutje nuk vazhdohet pavarësisht nevojave që dikush mundet me i pasë. Ky dokument ka edhe probleme tjera sepse pronari i tokës thotë hajde bleje se po i vyen fshatit, do të thotë janë probleme të dyfishta. Unë nuk po e akuzoj askend prej Komunës, por në rast se doni ju me insistue me vazhdue këtë projekt për mua hile ka. Ju edhe po i dini problemet, edhe po i shihni dhe po thoni jo, jo ka nevojë komuniteti. Mirpo, komuniteti ka nevojë në mënyrë të pastër me investue dhe me u bë korrekt, e jo ka problem peticioni, ka probleme vetë kërkesa e individit që e ka bërë hajde bleje tokën. Unë nuk po them se keni me ia ble shtrenjtë, se ka me ia ble bash të tij apo dikund është më e përshtatshme, nuk është e imja hiç, nuk e di sepse nuk kam informata të mjaftueshme. Mirëpo, për një gjë të tillë nuk votoj në asnjë moment dhe është dashtë asnjë anëtarë i Kuvendit mos me votue. Minimalisht është dashtë me këto probleme mos me kalue kjo, sqarohen detajet, shpallet edhe një herë një debat atje, shikohen pozicionet ku është më e favorshme dhe nuk e bën kërkësën ky që duhet me ia ble tokën. Është dashtë Kryetari i Komunës me bë kërkësën për këtë çështje, edhe kështu nuk ka me kalue sepse për interes të veçantë Kryetari me kërkësë të vetë e shpallë me interes një pjesë të caktuar dhe shkon e blen në rast se pajtohen 2 palët. Do të thotë se këto janë probleme që brenda po vërehet njëfarë hile dhe unë isha frigue me votue pavarësisht se Kuvendi nuk është duke u frigue se po bën shkelje. Krejtë kjo lëndë si procedurë është me probleme, prandaj jam kundër gjithsesi.

**Sami Ahmeti** – Unë nuk bëjë asnjë replikë në raport me fjalët që u thanë më heret, nuk është problem sikur që ka ligj dhe drejtësi për të gjithë besoj që ka edhe për neve, edhe për secilin. Pa asnjë dëshirë me bë lojë politike këtë punë, unë mendoj se është gabim kjo punë që po bëhet. Ato gjëra që i kemi përmendë edhe në seancën e kaluar dhe tash që i përmendëm kam konfirmim zyrtar prej ARC-së, se personi në fjalë ka vdekë në janar të vitit 2024. Ndoshta, ka edhe plot elemente tjera sikurse peticioni nuk i plotëson kriteret sepse është një rregullë se qysh duhet të jetë peticioni. Është një listë me emra dhe mbiemra pa asnjë tekst lartë veç me kërkësën dëshirore të vetë personit që don me shitë tokën, na është prezantue neve. Besoj që është gabim. Përveç, kësaj tashmë Presidentja ka shpallë zgjedhjet dhe neni 33 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale thotë që Kuvendi Komunal dhe Ekzekutivi nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve nuk mund të jetë, nuk mund të këmbej, nuk mund të bëjë asnjë aktivitet në raport me pronat, kështu që veç ju paralajmëroj secili që e voton tashmë nuk jeni pafajtor sepse po e dini se po e votoni një dokument të falsifikuar. Përndryshe, lëndë është kompletue dhe sqarimi që është bërë më vonë tashmë, është dërgue në polici dhe secili le të vepron sipas mendjes së vetë. Mirëpo, ne jemi shumë kundër këtij dokumenti.

**Kryesuesja** – Ju sqaroj lidhur me shkresën të cilën e potencuat, më ka ardhë në email prandaj unë e paraqita materialin, por paraprakisht pastaj edhe me lexue se çka ka ardhë nga Presidentja në lidhje me dhënen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

**Arben Berisha** – Unë e kam për çështjen mos me krijue mjegullajë lidhur me rendin e ditës dhe kërkësën. Ne nuk jemi duke dhënë pronë në shfrytëzim, por po inicjmë procedurat për shpronësimin e parcelës. Edhe në deklaratën e mëhershme që e kemi pasë në seancën e kaluar e kam thënë shumë qartë dhe këtë po e bëjë sa i përket opinionit, e jo parafolësit sepse nuk ia vlen as gjysmë shkronje me folë për tipin e tillë. Ne si Drejtori posa e kemi marrë kërkësën e kemi shikue vendin se a kemi lokacion më të përshtatshëm se aty. Do të thotë delë se lokacioni është i përshtatshëm për komunitetin që ata e kanë organizue dhe kërkue. Ne kemi organizue debat në ditën e caktuar dhe kemi dëshmitë ku pjesëmarrja ka qenë e mjaftueshme. Këtu, nuk po bëhet fjalë për një person, por për shumë persona dhe këta persona që janë aktual po supozohet një që ka bërë fals, që unë nuk e di ajo është çështje e tij, nuk është çështje e jona. Tash, unë uroj që policia me i dhënë kahje kësaj pune në të ardhmen, por si banorë kërkesa është në rregullë. Ne si Drejtori e kemi orientue për me shpallë zonë me interes dhe me i nisë procedurat e shpronësimit. Kjo, nuk do të thotë se me këtë seancë gjithçka përfundon sepse këtu ka shumë procedura dhe kjo çështje është e

kthjellët si loti, fshehje nuk ka dhe askush nuk ka lidhje me këtë punë përveç, se me ia krijue komunitetit një mirëqenie më të mirë aty ku jetojnë.

Pas daljes së kryesueses nga mbledhja, anëtarë më i vjetër i Kuvendit Komunal z. Enver Gashi vazhdoi me udhëheqjen e mbledhjes.

**Ajet Berisha** – Në bazë të buxhetit drejtor, unë nuk pashë që është planifikue diçka në këtë drejtim. E marrim apriori atje, janë 1 ha e 7,8 ari ose 10 ari se nuk e di saktë dhe po them se kushton dikund 500,000 €, prej cilës linjë buxhetore kemi me i marrë ato mjete.

**Arben Berisha** – Së pari kjo nuk kryhet brenda 5,6 muajve dhe në momentin që ne i nisim procedurat lëndën e dërgojmë në Ministri për me ardhë me bë vlerësimin dhe kjo zgjatë sepse ne e kemi praktikën që kemi shpronësue. Një këmbim që e kemi bërë ti e din dikund rrëth 6 vjet, gati na i ka marrë dhe kjo as në vitin 2026 nuk mund të përfundoj. Megjithatë, në 6 mujorin e vitit 2026 ne mundemi me parapa me buxhet dhe me rishikim të buxhetit. Ne i nisim procedurat sot brenda 2 muaj dite, i merrë njeriu mjetet, ne i ndërtojmë objektet dhe kjo punë nuk bëhet sepse ka shumë procedura, bile z. Ajet ti ke qenë në ngjarje një shpronësim që e kemi bërë atje në Milloshevë na i ka marrë 3,4 vjet, një rrugë që e kemi zgjerue që nuk e di a kanë qenë 7,8 ari në pyetje. Nuk fajësohet as Ministria, as ne por vetë është çështja e lëndës shumë e ndijshme dhe ka shumë procedura, kështu që për çështjen buxhetore kjo mund të shihet pas sepse mund të na humbin mjetet qysh na kanë humb 2,3 herë radhazi dhe nuk kemi mund me i krye procedurat.

**Enver Gashi** – E hedhi në votim çështjen për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Plementin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 10 vota për dhe 8 vota kundër morën Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plementin.

**Liridona Shabani** – Në pyetjen e paraqitur nga anëtarë i Kuvendit z. Labinot Mirena, rrëth mossubvencionimit të OJQ klubit “Kalërimi” në Mazgit kemi një përgjegje e cila edhe është paraqitë në raport. Në bazë të Rregullores për thirrje publike dhe në bazë të Rregullores nga Ministria e financave nëse, një OJQ klub nuk sjellë raport financier të kompletuar, ai e humbë të drejtën për 3 vite për përfitim në subvencione. Prandaj, nga Komisioni është vlerësue se ky klub nuk ka sjellë raport të kompletuar dhe është eliminue nga përfshirja në subvencionim.

**Valbonë Beka** – Unë kam 2 kërkesa, por ajo që është më kryesorja për shkollën “Ibrahim Rugova” toaletet në katin e parë janë tmerr. Këtë vit shkollar që e lamë në disa klasë ka qenë aromë tepër e rëndë dhe nxënësit nuk kanë mund të qëndrojnë aty prej erës së keqe. Pysë a ka mundësi me fillue punimet menjëherë dhe të rregullohen ato sepse kur po fillon viti shkollor edhe po i pengon nxënësit edhe nuk po kryhet puna qysh duhet. Kërkesën tjetër e kam për praktikën profesionale, një buxhet që jepet prej Ministrisë së Arsimit për praktikën profesionale për shkollën “Ismail Dumoshi” të cilin buxhet ne nuk e marrim ashtu qysh e meritojmë, a ka mundësi buxheti që jepet për praktikë profesionale prej Ministrisë, me u shfrytëzue çdo vit për praktikë profesionale në shkollën tonë.

**Shaip Paloja** – Unë e kam një kërkesë, por edhe si pyetje më intereson se çka është duke ndodhë me ndriçimin publik në përgjithësi gati gjithandej, mirëpo në veçanti rruga Obiliq-Palaj, dhe një pjesë e madhe është pa ndriçim, nuk e di çka është duke ndodhë, pse nuk po ndërrohen poqat.

**Labinot Mirena** – Unë e kam një kërkesë për fshatrat Hade, Hamidi, Shipitullë dhe Grabofc, këto fshatra nuk kanë asnje transport publik. Pasi që ne i kemi disa kombibusë këtu, ne po i bëjmë zgjidhje secilit dhe është mirë me bë një orar të paktën, është mirë me shkue 3,4 herë në ditë deri në Grabofc. Këto fshatra i ka harrue shteti i Kosovës, do të thotë Qeveria ka bërë ndarje janë gati krejtë të shpronësuar, por ata pak banorë që janë atje, bile me ditë që janë qytetarë të kësaj Komune. Mundeni me bë ndonjë memorandum bashkëpunimi edhe me Komunën e Fushë Kosovës, që vijnë aty në Grabofc deri te xhamia me autobusë me ua bë me shkue edhe 3,4 km deri te restoranti që është atje, te guri i plakës dhe me iu krye shërbim atyre që shkojnë në Fushë Kosovë. Unë besoj se Komuna e Fushë Kosovës mundet me ua oblige operatorëve të vetë me shkue deri atje, sepse nuk është ndonjë dëm i madh që iu bëhet operatorëve. Ne për shembull e kemi transportin Barileva që i bjen në krejtë territorin e Komunës tonë dhe shkon në Prishtinë, kështu që

për 3,4 km është dashtë me iu bë zgjidhja atyre banorëve atje. Mirëpo, jo vetëm atyre por edhe Hades, Hamidisë dhe Shipitullës me iu bë zgjidhja sepse nuk kanë transport publik.

**Jeton Mjekiqi** – Sa i përket transportit prej viti 2013-në 12 ose 13 takime kemi qenë në Komunën e Fushë Kosovës edhe si banorë edhe si Komunë. E kemi bërë stacionin te restoranti ku po thua, bëne më shpejtë se kemi me lëshue transportin, Komuna ka intervenuesë ka shtruese me zhvaorr, e ka bërë vendin. Në fund u deklarue Komuna e Fushë Kosovës, se operatorët janë privat dhe nuk mundet me ia imponue. Problemi tjetër është se i bjen me kalue në 3 Komuna dhe në momentin që i bjen me kalue në 3 Komuna, duhet me hy në stacion të autobusëve, e jo me hy nëpër qytet. Për këtë arsyen edhe nuk po pranojnë operatorët e Fushë Kosovës. Sa i përket kombibusit janë mbi 20 kërkesa të qytetarëve të Grabofcit e Shipitullës, që i kemi bërë bashkarisht, por nuk ka transport. Ndërsa, sa i përket Fushë Kosovës edhe si qytetarë edhe si Komunë i kemi bërë 12 ose 13 takime me Komunën e Fushë Kosovës.

**Labinot Mirena** – Kjo ishte kërkesa ime nëse janë 20 kërkesa Komuna e Obiliqit duhet mi marrë parasysh hallet e atyre banorëve, atje dhe me pasë mundësi të lërvizjes së lirë. Ne këtu, ua japim autobusin në shfrytëzim ose kombibusët në mënyrë që atyre banorëve me ua sigurue transportin sepse kanë nevojë për udhëtim. Edhe memorandumet e bashkëpunimeve bëhen edhe Komuna e Fushë Kosovës është Komunë mike e jona, qysh po bëjnë për infrastrukturë që e lidhë fshatin Dardhishtë me Fushë Kosovën, është mirë me bë edhe për transport publik sepse ata qytetarë atje, kanë nevojë urgjente për zgjidhjen e problemit të transportit.

**Naim Miftari** – Përgjegjet se sa i përket rregullimit të ndriçimit publik procedurat e tenderimit janë në OSHP dhe në momentin që do të bëhet një zgjidhje e kësaj situate atëherë, padyshim që do të bëhet rregullimi i këtyre dritave. Besoj se brenda një kohe të shkurtë vetëm do të bëhet lidhja e kontratës dhe zëvendësimi i dritave aty ku janë të djegura.

Mbledhja përfundoi në ora 11:42'

Bashk. prof për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Këbashi

